



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMI I CILËSISË  
SEKTORI I KURRIKULAVE

LEGJENDA E DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS


---

*Fusha 2*

***Dokumenti.14.***

Plan veprimi per sigurimin e brendeshem te cilesise  
21-24 ne UT





Nr. 449 Prot.

04.4.2022



-Anëtarëve të Kolegjit

04.4.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMI I CILËSISË  
SEKTORI I SIGURIMIT TË CILËSISË

Nr. 172 / 2 Prot

Tiranë më 04.4.2022

Lënda: Përcillet Vendimi i Rektoratit nr. 08, datë 29.03.2022

Drejtuar: Prof. Dr. Dhori Kule  
Dekan i Fakultetit të Ekonomisë

Bashkëlidhur, ju përcjellim Vendimin e Rektoratit nr. 08, datë 29.03.2022 për "Miratimin e planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 në Universitetin e Tiranës" së bashku me planin e veprimit.

REKTORI  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Prof. Dr. Artan Hoxha  
UNIVERSITETI I TIRANËS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 172/Prot.

Tiranë, më 30.3.2022

VENDIM

Nr. 08, datë 29.03 2022

**“Për miratimin e planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024 në  
Universitetin e Tiranës”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 103, Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 138 si dhe shkresën e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UT me nr. 172 prot., datë 19.01.2022 me lëndë: “Dërgohet për miratim plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024”, në mbledhjen e datës 29.03.2022 Rektorati i Universitetit të Tiranës,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “Planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024”.
2. Përcjelljen e tij për zbatim në njësitë kryesore të UT.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS

**PLANI I VEPRIMIT PËR SIGURIMIN E  
BRENDSHËM TË CILËSISË  
(SHTATOR 2021 – GUSHT 2024)**



## Hyrje

Universiteti i Tiranës është i përkushtuar për arritjen e standardeve më të larta të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e tij. Ky parim është i lidhur me vizionin e UT-së për të qenë model i arsimit të lartë publik i karakterizuar nga përgatitje rigorozë akademike dhe kërkim i thelluar shkencor si dhe në parimet për menaxhimin e cilësisë. UT është i vetëdijshëm se cilësia, përmirësimi i vazhdueshëm dhe përbushja e pritshmërive është një parakusht për zhvillimin dhe ekzistencën afatgjatë të tij.

Për të garantuar cilësinë UT ka miratuar Manualin e Cilësisë. Ky dokument artikulon politikën e sigurimit të cilësisë, parimet e menaxhimit të cilësisë, standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, përcakton rolin dhe përgjegjësitë e organizmave akademike dhe organizativë për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë, paraqet praktikat dhe instrumentet përkatëse.

Plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshin qëllimet dhe objektivat e UT-së për sigurimin e brendshëm të cilësisë në periudhën Shtator 2021- Gusht 2024. Qëllimi i këtij plani veprimi është të përcaktojë masa konkrete për sigurimin të cilësisë për të kontribuar në përmirësimin e gjithë veprimtarisë së tij, akreditimin e programeve të studimit dhe riakreditimin institucional.

Ky plan veprimi fokusohet në tre fusha:

- (i) strukturat dhe menaxhimi;
- (ii) cilësia e programeve, mësimdhënia dhe mësimnxënia;
- (iii) përfshirja e studentëve në SBC

të përfaqësuara në plan përmes qëllimeve strategjike, objektivave specifike dhe masave të ndërlidhura me to.

## Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike

**Qëllimi strategjik I:** Fuqizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë me qëllim arritjen e standardeve kombëtare

Treguesit kryesorë të rezultateve nën këtë qëllim strategjik janë:

- Struktura të riorganizuara/krijuara dhe funksionale në Institucion dhe në të gjitha Njësitë kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë
- Rregullore/procedura të përditësuara me detyrimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë
- Kapacitete të rritura të stafit për SBC.

**Objektivi specifik: I.1:** Struktura dhe mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë të fuqizuara për të arritur qëllimet strategjike të UT-së

**Masat/Rezultatet e pritshme dhe aktivitetet.**



Në vijim janë dhënë masat dhe aktivitetet e ndërlidhura me objektivin specifik I.1

**Masa I.1.1** Ngritja e strukturave efektive për sigurimin e brendshëm të cilësisë

*I.1.1.a Riorganizimi i NJSBC-së në nivel institucioni*

*I.1.1.b Standartizimi i NJSBC-ve në të gjitha Njësitë kryesore të UT-së*

*I.1.1.c Fuqizimi i kapaciteteve të sektorit për sigurimin e brendshëm të cilësisë*

*I.1.1.d Hartimi i planeve të punës për SBC në të gjitha Njësitë Kryesore*

**Masa I.1.2** Rritja e kapaciteteve të stafit për zbatimin e politikave/ standarteve të SBC

*I.1.2.a Hartimi dhe miratimi i planit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024*

*I.1.2.b Raport vjetorë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë*

*I.1.2.c Trajnimi periodik i të gjithë stafit të NJSBC-ve për aspekte të ndryshme të SBC*

*I.1.2.d Zhvillimi i bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet NJSBC-ve*

*I.1.1.e Auditim i brendshëm për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e sektorit të sigurimit të cilësisë*

**Masa I.1.3.** Përmirësimi i statistikave dhe të dhënave në funksion të SBC

*I.1.3.a Workshop me antarë të GVB "Aksesi dhe cilësia e të dhënave të nevojshme për hartimin e RVB"*

*I.1.3.b Fuqizimi i kapaciteteve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në njësinë kryesore dhe njësitë bazë*

**Treguesit në nivel masash janë:**

- NJSBC në nivel institucioni e riorganizuar
- NJSBC në nivel të Njësive Kryesore të krijuara
- Numri i rregulloreve/procedurave të rishikuara
- Numri i trajnimeve të zhvilluara/numri i personave të trajnuar
- Numri i planeve të hartuara/rishikuara
- Raporte monitorimi

**Qëllimi strategjik II:** Të zhvillojmë dhe të ofrojmë rezultate të qëndrueshme në mësimdhënie, të nxëniet dhe vlerësimin e studentëve

Treguesit kryesorë të rezultateve nën këtë qëllim strategjik janë:

- Programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të akredituara
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së ofertës akademike në të gjitha ciklet e studimit
- Kapacitete të rritura të personelit për mësimdhënie



**Objektivi specifik: II.1:** Personeli i UT-së është i vetëdijshëm dhe kupton ciklet, proceset dhe instrumentet përkatëse të cilësisë

**Masat/Rezultatet e pritshme dhe aktivitetet.**

Në vijim janë dhënë masat dhe aktivitetet e ndërlidhura me objektivin specifik II.1.

**Masa II.1.1 Ndarja e informacionit dhe standardizimi i procedurave të vlerësimit të brendshëm**

*II.1.1.a Krijimi i grupeve në Teams për akreditimin e programeve të ciklit të parë dhe të dytë*

*II.1.1.b Orientimi i antarëve të GVB me procedurat dhe proceset e vlerësimit të brendshëm*

*II.1.1.c Grumbullimi i dokumenteve dhe evidencave për RVB*

**Masa II.1.2 Rritja e kapaciteteve të personelit akademik për SBC**

*II.1.2.a Rritja e kapaciteteve të GVB për hartimin e RVB-ve*

*II.1.2.b Kryerja e seminareve me stafin akademik për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënësve*

*II.1.2.c Trajnimi periodik i të gjithë personelit akademik për aspekte të ndryshme të SBC*

**Masa II.1.3. Vlerësimi i përformancës të personelit akademik**

*II.1.3.a Ngrita e kapaciteteve për vlerësimin e përformancës të personelit akademik*

*II.1.3.b Planifikimi i objektivave sipas veprimtarive*

*II.1.3.c Analiza e realizimit të objektivave sipas veprimtarive*

*II.1.3.d Vlerësimi i lëndëve nga pedagogët/Pyetësorë vetëvlerësimi*

**Treguesit në nivel masash janë:**

- Numri i programeve të studimit të akredituara
- Numri i antarëve të GVB të trajnuar
- Numri i trajnimeve të zhvilluara
- Përfshirja e të paktën 20% të stafit në GVB
- Kënaqësia me cilësinë e mësimdhënies

**Qëllimi strategjik III:** Të mundësojmë që studentët të luajnë një rol aktiv në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha veprimtaritë e UT-së

**Treguesit kryesorë të rezultateve nën këtë qëllim strategjik janë:**

- Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që studentët të marrin pjesë masivisht në vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies
- Rezultate të përmirësuar me kalimin e kohës kundrejt një seri pyetjesh kryesore që u bëhen studentëve./ Fokus grupe



**Objektivi specifik: III.1:** Studentët luajnë një rol aktiv në formësimin e kulturës të mësimdhënies dhe të nxënësve

**Masat/Rezultatet e pritshme dhe aktivitetet.**

Në vijim janë dhënë masat dhe aktivitetet e ndërlidhura me objektivin specifik III.1.

**Masa III.1.1 Kryerja e anketave të kënaqësisë të palëve të interesuara**

*III.1.1.a Realizimi i vlerësimit të lëndëve nga studentët periodikisht*

*III.1.1.b Realizimi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët periodikisht*

*III.1.1.c Realizimi i vlerësimit me studentët e diplomuar periodikisht*

*III.1.1.d Fuqizimi i kapaciteteve të sektorit për sigurimin e cilësisë për përpunimin e të dhënave të pyetësorëve*

*III.1.1.e Hartimi i kalendarit për kryerjen e pyetësorëve në të gjitha Njësitë Kryesore*

**Masa III.1.2 Njohja e studentëve me rezultatet e vlerësimit dhe përmirësimet e arritura**

*III.1.2.a Diskutimi i gjetjeve të vlerësimit me grupe studentësh në nivel Departamenti*

*III.1.2.b Publikimi i raporteve të vlerësimit*

**Treguesit në nivel masash janë:**

- % e studentëve që marrin pjesë në vlerësimin e stafit akademik
- % e studentëve që marrin pjesë në vlerësimin e lëndës
- % e studentëve që diplomohen që marrin pjesë në vlerësim
- Numri i raporteve të vlerësimit të publikuara





**PLANI I SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (1 SHTATOR 2021 – 31 GUSHT 2024)**

FUSHA	STRUKTURAT DHE MENAXHIMI				
Qëllimi strategjik I	Fuqizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë me qëllim arritjen e standardeve kombëtare				
Objektivi specifik: I.1	Struktura dhe mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë të fuqizuara për të arritur qëllimet strategjike të UT-së				
Rezultate të pritura:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura të riorganizuara/krijuara dhe funksionale në Institucion dhe në të gjitha Njësitë kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë</li> <li>• Rregullore/procedura të përditësuara me detyrimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë</li> <li>• Kapacitete të rritura të stafit për SBC</li> </ul>				
Treguesit:			<b>Baseline (2021)</b>	<b>Synimet (2024)</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• NJSBC në nivel institucioni e riorganizuar</li> <li>• NJSBC në nivel të Njësive Kryesore të krijuara</li> <li>• Numri i rregulloreve/procedurave të rishikuara</li> <li>• Numri i trajnimeve të zhvilluara/numri i personave të trajnuar</li> <li>• Numri i planeve të hartuara/rishikuara</li> <li>• Raporte monitorimi</li> </ul>		0 2 1 7/210 1 0	1 8 8 21/500 2 3	
Masat dhe aktivitetet	Produkti	Njësia/organi përgjegjës	Njësia/organet partnere	Afatet	Buxheti
Masa I.1.1 Ngritja e strukturave efektive për sigurimin e					



<b>brendshëm të cilësisë</b>					
<i>I.1.1.a Riorganizimi i NJSBC-së në nivel institucioni</i>	<i>Miratimi i antarëve të rinj të NJSBC-së</i>	<i>Rektorati</i>	<i>Dekanatet</i>	<i>Dhjetor 2021-Janar 2022</i>	<i>Honorare për antarët e NJSBC-së</i>
<i>I.1.1.b Standartizimi i NJSBC-ve në të gjitha Njësitë kryesore të UT-së</i>	<i>Struktura të ngritura në të gjitha Njësitë Kryesore</i>	<i>Njësitë Kryesore</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme</i>	<i>Shtator-Tetor 2021</i>	<i>Fond page ????</i>
<i>I.1.1.c Fuqizimi i kapaciteteve të sektorit për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>	<i>Rishikimi i rregullores së Rektoratit (amendimi i pëshkrimit të punës për sektorin e SBC)</i>	<i>Rektorati</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme</i>	<i>Janar 2022</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>I.1.1.d Hartimi i planeve të punës për SBC në të gjitha Njësitë Kryesore</i>	<i>Plane veprimi të hartuara dhe miratuara</i>	<i>Zv.Dekani për Sigurimin e Cilësisë</i>	<i>Dekanati NJSBC</i>	<i>Janar-Mars 2022</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<b>Masat dhe aktivitetet</b>	<b>Produkti</b>	<b>Njësia/organi përgjegjës</b>	<b>Njësia/organet partnere</b>	<b>Afatet</b>	<b>Buxheti</b>
<b>Masa I.1.2 Rritja e kapaciteteve të stafit për zbatimin e politikave/standarteve të SBC</b>					
<i>I.1.2.a Hartimi dhe miratimi i planit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024</i>	<i>Plani i miratuar</i>	<i>Senati akademik</i>	<i>Zv.Rektori për anën mësimore KPSSC</i>	<i>Dhjetor 2021</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>I.1.2.b Raport vjetorë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i>	<i>Raport monitorimi</i>	<i>Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë</i>	<i>NJSBC KPSSC</i>	<i>Janar 2022-Gusht 2024</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>I.1.2.c Trajnimi periodik i të gjithë stafit të NJSBC-ve për aspekte të ndryshme të</i>	<i>Të paktën dy trajnime në vit</i>	<i>Drejtoria e Kurrikulave dhe</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve të</i>	<i>Januar 2022-Gusht 2024</i>	<i>Honorar vetëm për ekspertët e</i>



SBC		Sigurimit të Cilësisë	Brendshme KPSSC ASCAL		jashtëm
I.1.2.d Zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet NJSBC-ve	Takime periodike për ndarjen e eksperiencave	Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë	NJSBC KPSSC	Januar 2022- Gusht 2024	Nuk ka nevojë për buxhet shtesë
I.1.1.e Auditim i brendshëm për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e sektorit të sigurimit të cilësisë	Raporti i auditimit	Sektori i auditimit të performancës	Rektorati Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë	Shtator 2023	Nuk ka nevojë për buxhet shtesë
Masat dhe aktivitetet	Produkti	Njësia/organi përgjegjës	Njësia/organet partnere	Afatet	Buxheti
<b>Masa I.1.3. Përmirësimi i statistikave dhe të dhënave në funksion të SBC</b>					
I.1.3.a Workshop me antarë të GVB "Aksesi dhe cilësia e të dhënave të nevojshme për hartimin e RVB"	2 workshope	Zv. Rektori	NJSBC-të Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë/KPSSC	Mars-Prill 2022	Nuk ka nevojë për buxhet shtesë
I.1.3.b Fuqizimi kapaciteteve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në njësinë kryesore dhe njësitë bazë	Trajnime me strukturat përgjegjëse në Njësitë Kryesore	Zv. Rektori	NJSBC-të Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë/KPSSC	Prill- Qershor 2022	Nuk ka nevojë për buxhet shtesë



FUSHA	<u>CILËSIA E PROGRAMEVE, MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA</u>				
Qëllimi strategjik II	Të zhvillojmë dhe të ofrojmë rezultate të qëndrueshme në mësimdhënie, të nxëniet dhe vlerësimin e studentëve				
Objektivi specifik: II.1	Personeli i UT.së është i vetëdijshëm dhe kupton ciklet, proceset dhe instrumentet përkatëse të cilësisë.				
<u>Rezultate të pritura:</u>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të akredituara</li> <li>• Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së ofertës akademike në të gjitha ciklet e studimit</li> <li>• Kapacitete të rritura të personelit për mësimdhënie</li> </ul>				
<u>Treguesit:</u>				<b>Baseline (2021)</b>	<b>Synimet (2024)</b>
Masat dhe aktivitetet	Produkti	Njësia/organi përgjegjës	Njësia/organet partnere	Afatet	Buxheti
<b>Masa II.1.1 Ndarja e informacionit dhe standardizimi i procedurave të vlerësimit të brendshëm</b>					
<i>II.1.1.a Krijimi i grupeve në Teams për akreditimin e programeve të ciklit të parë dhe të dytë</i>	<i>Grupet të Teams</i>	<i>Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë</i>	<i>Dekanatet NJSBC KPSSC</i>	<i>Tetor 2021</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.1.b Orientimi i antarëve të GVB me</i>	<i>Takimi i organizuar me</i>	<i>Rektorati</i>	<i>KPSSC</i>	<i>Tetor 2021</i>	<i>Nuk ka nevojë</i>



<i>procedurat dhe proceset e vlerësimit të brenshëm</i>	<i>pjesëmarrjen e stafit të ASCAL</i>		<i>NJSBC</i>		<i>për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.1.c Grumbullimi i dokumenteve dhe evidencave për RVB</i>	<i>Dokumente dhe evidenca (min 52)</i>	<i>Zv.Dekani për Sigurimin e Cilësisë</i>	<i>NJSBC</i> <i>Departamentet</i>	<i>Nintor 2021-Shkurt 2022</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<b>Masat dhe aktivitetet</b>	<b>Produkti</b>	<b>Njësia/organi përgjegjës</b>	<b>Njësia/organet partnere</b>	<b>Afatet</b>	<b>Buxheti</b>
<b>Masa II.1.2 Rritja e kapaciteteve të personelit akademik për SBC</b>					
<i>II.1.2.a Rritja e kapaciteteve të GVB për hartimin e RVB-ve</i>	<i>Trajnime të zhvilluara për të gjitha fushat e vlerësimit për të dy ciklet</i>	<i>Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë</i>	<i>KPSSC</i> <i>NJSBC</i> <i>Dekanatet</i>	<i>Tetor -Dhjetor 2021</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.2.b Kryerja e seminareve me stafin akademik për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit</i>	<i>Seminare të realizuara në Njësitë Kryesore</i>	<i>NJSBC</i>	<i>Dekani</i> <i>Njësitë bazë</i>	<i>Qershor 2022-Gusht 2024</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.2.c Trajnimi periodik i të gjithë personelit akademik për aspekte të ndryshme të SBC</i>	<i>Të paktën dy trajnime në vit</i>	<i>Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme</i> <i>KPSSC</i> <i>NJSBC</i>	<i>Prill 2022-Gusht 2024</i>	<i>Honorar vetëm për eksperët e jashtëm</i>
<b>Masat dhe aktivitetet</b>	<b>Produkti</b>	<b>Njësia/organi përgjegjës</b>	<b>Njësia/organet partnere</b>	<b>Afatet</b>	<b>Buxheti</b>
<b>Masa II.1.3. Vlerësimi i përformancës të personelit akademik</b>					
<i>II.1.3.a Ngrita e kapaciteteve për vlerësimin e përformancës të personelit</i>	<i>Trajnime të zhvilluara</i>	<i>Rektorati</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve të</i>	<i>Mars-Qershor</i>	<i>Nuk ka nevojë</i>



<i>akademik</i>			<i>Brendshme NJSBC</i>	<i>2022</i>	<i>për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.3.b Planifikimi i objektivave sipas veprimtarive</i>	<i>Formularë të plotësuar</i>	<i>Njësitë bazë</i>	<i>NJSBC-të Dekanati BNJ</i>	<i>Tetor 2022</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.3.c Analiza e realizimit të objektivave sipas veprimtarive</i>	<i>Formularë të plotësuar</i>	<i>Njësitë bazë</i>	<i>NJSBC-të Dekanati BNJ</i>	<i>Shtator 2023</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>II.1.3.d Vlerësimi i lëndëve nga pedagogët</i>	<i>Raportet e vetëvlerësimit</i>	<i>Përgjegjësit e Departamentit</i>	<i>NJSBC</i>	<i>Shtator 2022</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>

<b>FUSHA</b>	<b>PËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË SBC</b>	
Qëllimi strategjik III	Të mundësojmë që studentët të luajnë një rol aktiv në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha veprimtaritë e UT-së.	
Objektivi specifik: III.1	Studentët luajnë një rol aktiv në formësimin e kulturës të mësimdhënies dhe të nxënit	
Rezultate të pritura:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që studentët të marrin pjesë masivisht në vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies</li> <li>• Rezultate të përmirësuara me kalimin e kohës kundrejt një seri pyetjesh kryesore që u bëhen studentëve</li> </ul>	
Treguesit:	<b>Baseline (2021)</b>	<b>Synimet (2024)</b>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>% e studentëve që marrin pjesë në vlerësimin e stafit akademik</li> <li>% e studentëve që marrin pjesë në vlerësimin e lëndës</li> <li>% e studentëve që diplomohen që marrin pjesë në vlerësim</li> <li>Numri i raporteve të vlerësimit të publikuara</li> </ul>			0	85%
				0	75%
				1	11/220
Masat dhe aktivitetet	Produkti	Njësia/organi përgjegjës	Njësia/organet partnere	Afatet	Buxheti
<b>Masa III.1.1 Kryerja e anketave të kënaqësisë të palëve të interesuara</b>					
III.1.1.a Realizimi i vlerësimit të lëndëve nga studentët periodikisht	Raporte periodike vlerësimi (2 raporte në vit)	NJSBC e UT-së	NJSBC në Njësitë Kryesore Departamentet	Shkurt 2022-Korrik 2024	Honorare për antarët e NJSBC-së
III.1.1.b Realizimi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët periodikisht	Raporte periodike vlerësimi (2 raporte në vit)	NJSBC e UT-së	NJSBC në Njësitë Kryesore Departamentet	Shkurt 2022-Korrik 2024	Honorare për antarët e NJSBC-së
III.1.1.c Realizimi i vlerësimit me studentët e diplomuar periodikisht	Raport periodik vlerësimi (1 raport në vit)	NJSBC e UT-së	NJSBC në Njësitë Kryesore Departamentet	Korrik 2022-Korrik 2024	Honorare për antarët e NJSBC-së
III.1.1.d Fuqizimi i kapaciteteve të sektorit për sigurimin e cilësisë për përpunimin e të dhënave të pyetësorëve	Rishikimi i rregullores së Rektoratit (amendimi i pëshkrimit të punës për sektorin e SBC)	Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë	Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave	Janar Korrik 2022	Buxhet për software nëse nevojitet
III.1.1.e Hartimi i kalendarit për kryerjen e pyetësorëve në të gjitha Njësitë	Kalendari i hartuar për çdo vit akademik	Zv. Rektori për anën mësimore	Zv. Dekani për Sigurimin e	Janar 2022	Nuk ka nevojë për buxhet



<i>Kryesore</i>			<i>Cilësisë NJSBC</i>		<i>shtesë</i>
<b>Masat dhe aktivitetet</b>	<b>Produkti</b>	<b>Njësia/organi përgjegjës</b>	<b>Njësia/organet partnere</b>	<b>Afatet</b>	<b>Buxheti</b>
<b>Masa III.1.2 Njohja e studentëve me rezultatet e vlerësimit dhe përmirësimet e arritura</b>					
<i>III.1.2.a Diskutimi i gjetjeve të vlerësimit me grupe studentësh në nivel Departamenti</i>	<i>Diskutime të realizuara</i>	<i>Zv.Dekani për Sigurimin e Cilësisë</i>	<i>Njësitë bazë NJSBC-të</i>	<i>Mars 2022-Korrik 2024</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>
<i>III.1.2.b Publikimi i raporteve të vlerësimit</i>	<i>Raport vlerësimi të publikuara</i>	<i>Zv Rektori për anën mësimore</i>	<i>Zv.Dekani për Sigurimin e Cilësisë NJSBC KPSSC</i>	<i>Mars 2022-Korrik 2024</i>	<i>Nuk ka nevojë për buxhet shtesë</i>

